

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Basics**

B2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 05/02/2022

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Në vitet e fundit, cili nga dy faktorët e mëposhtëm e ka ndryshuar marrëdhënien ndërmjet auditorëve të brendshëm dhe auditorëve të jashtëm në mënyrë që auditorët e brendshëm të jenë partnerë të auditorëve të jashtëm dhe jo vartës?
 - A. Rritja e përgjegjësisë së auditorëve të jashtëm dhe rritja e profesionalizmit të auditorëve të brendshëm.
 - B. Rritja e profesionalizmit të auditorëve të brendshëm dhe zhvillimi i ekonomisë së auditimit të jashtëm.**
 - C. Mbështetja e shtuar në sistemet e kompjuterizuara të kontabilitetit dhe ekonomia në zhvillim e auditimit të jashtëm.
 - D. Globalizimi i subjekteve audituese dhe rritja e mbështetjes në sistemet e kompjuterizuara të kontabilitetit.
2. Pas përdorimit të së njëjtës firmë të auditimit për disa vite, bordi i drejtorëve angazhoi një tjetër firmë të auditimit për të kryer auditimin financiar vjetor me qëllim uljen e tarifës vjetore të auditimit. Firma e re e auditimit ka propozuar që të bëhet një auditim vetëm një herë i efektivitetit të kostos së operacioneve të ndryshme të biznesit. Shefit ekzekutiv të auditimit i është kërkuar që të këshillojë menaxhmentin në marrjen e një vendimi për propozimin. Kriteret shtesë që duhet të merren parasysh nga menaxhmenti në vlerësimin e propozimit do të përfshijnë të gjitha më poshtë përveç:
 - A. Ekspertiza ekzistuese e stafit të auditimit të brendshëm.
 - B. Kostoja e përgjithshme e auditimit të propozuar.
 - C. Nevoja për të zhvilluar ekspertizë të brendshme.
 - D. Auditori i jashtëm kërkon respektimin e konceptit të auditimit të vetëm.**
3. Për të përmirësuar efikasitetin e auditimit, auditorët e brendshëm mund të mbështeten në punën e auditorëve të jashtëm nëse:
 - A. Puna kryhet pas auditimit të brendshëm.
 - B. Kryesisht ka të bëjë me objektivat dhe aktivitetet operative.
 - C. Puna është koordinuar me auditimin e brendshëm.**
 - D. Puna është kryer në përputhje me Kodin e Etikës.
4. Cili nga faktorët e mëposhtëm mund të jetë një faktor organizativ që mund të ndikojë negativisht në sjelljen etike të shefit ekzekutiv të auditimit?
 - A. Shefi ekzekutiv i auditimit i raporton drejtpërdrejt një komiteti të pavarur të auditimit të bordit të drejtorëve.
 - B. Shefit ekzekutiv të auditimit nuk i është caktuar asnjë përgjegjësi operacionale.
 - C. Shefi ekzekutiv i auditimit nuk mund të emërohet apo miratohet pa pëlqimin e bordit të drejtorëve.
 - D. Bonuset vjetore të shefit ekzekutiv të auditimit bazohen në reduktimin e kostove të ardhshme të rekomanduara si rezultat i auditimeve.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

5. Ju jeni shefi ekzekutiv i auditimit të brendshëm të një kompanie mëmë që ka filiale të huaja. Auditimi i jashtëm i pavarur i kryer për kompaninë mëmë nuk kryhen nga e njëjta firmë që kryen auditimet e filialeve të huaja. Meqenëse departamenti juaj herë pas here ofron ndihmë të drejtpërdrejtë për të dy firmat e jashtme, ju keni kopje të programeve të auditimit dhe dokumente të zgjedhura pune të prodhuara nga secila firmë. Firma e auditimit e filialit të huaj do të donte të mbështetej në disa nga punët e kryera nga firma e auditimit të kompanisë mëmë, por ajo duhet të rishikojë së pari dokumentet e punës. Firma e auditimit e filialit ju ka kërkuar kopje të dokumenteve të punës të firmës së auditimit të jashtëm të kompanisë mëmë. Zgjidhni përgjigjen më të përshtatshme për auditorët e jashtëm të filialit të huaj:
- A. Siguroni kopjet e dokumenteve të punës pa njoftuar firmën e auditimit të kompanisë mëmë.
 - B. Njoftoni firmën e auditimit të kompanisë mëmë për situatën dhe kërkonte që ajo ose të sigurojë dokumentet e punës ose t'ju autorizojë për ta bërë këtë.**
 - C. Jepni kopje të dokumenteve të punës dhe njoftoni firmën e auditimit të kompanisë mëmë që e keni bërë këtë.
 - D. Refuzoni të jepni letrat e punës në çdo rrethanë.
6. Një auditor i brendshëm, i larguar së fundmi nga një kompani për shkak të shkurtimit të stafit, ka gjetur punë në një kompani tjetër në të njëjtën industri. Cila nga veprimet e mëposhtme të bëra nga auditori i brendshëm për kompaninë e re do të përbënte shkelje të Kodit të Etikës?
- A. Auditori përdori qasjen e bazuar në rrezik të auditimit që u përdor nga ish-punëdhënësi i auditorit në përcaktimin e prioriteteve të auditimit në punën e re.
 - B. Departamenti i ri i auditimit nuk përdor probabilitetin proporcional me madhësinë (PPS) të mostrës dhe auditori beson se mostrimi sipas PPS ka përparësi për shumë nga llojet e auditimeve të kryera nga punëdhënësi i ri. Auditori zhvilloi sesione trajnimit dhe formularë për zbatimin e mostrimit në të njëjtën mënyrë si punëdhënësi i mëparshëm.
 - C. Ndërsa ishte i punësuar në kompaninë e mëparshme, auditori kreu një hulumtim të gjerë për të identifikuar "praktikat më të mira" për menaxhimin e departamentit të thesarit si pjesë e një auditimi për atë kompani. Meqenëse pjesa më e madhe e hulumtimit është bërë në shtëpi dhe jashtë orarit të punës, auditori ka mbajtur pjesën më të madhe të hulumtimit dhe planifikon ta përdorë atë në kryerjen e auditimit të departamentit të thesarit tek punëdhënësi i ri.
 - D. Asnjë nga zgjedhjet nuk paraqet shkelje të Kodit të Etikës.**
7. Kodi i etikës së një organizate profesionale përcakton:
- A. Standarde të gjera sjelljeje për anëtarët e organizatës.**
 - B. Detajet organizative të organit drejtues të profesionit.
 - C. Një listë të aktiviteteve të jashtë-ligjshme që janë të ndaluara për anëtarët e profesionit.
 - D. Kriteret me të cilat duhet të vlerësohet dhe matet performanca e aktiviteteve profesionale.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

8. Kodi i Etikës identifikon tre parime që formojnë themelin mbi të cilin mbështetet i gjithë Kodi. Cila nga opsionet e mëposhtme NUK është një nga këto tre parimet e Kodit të Etikës?
- A. Objektiviteti.
 - B. Kujdesi i duhur.
 - C. Drejtësia**
 - D. Integriteti.
9. Sipas dispozitave të Kodit të Etikës në lidhje me dhuratat dhe pagesat, cila nga sa situatat në vijim do të ishte e pranueshme për një auditor të brendshëm?
- A. Një stilolaps i marrë nga menaxheri i shitjeve të një filiali të kompanisë me emrin e produktit të kompanisë dhe një numër telefoni.**
 - B. Një darkë dhe bileta për ndeshje të futbollit nga menaxheri i një departamenti që auditohet. Biletat zakonisht vihen në dispozicion të punonjësve të departamentit të audituar.
 - C. Një darkë dhe bileta për ndeshje të futbollit nga menaxheri i një departamenti që nuk është audituar kurrë dhe për të cilin nuk ka plane për një auditim të ardhshëm. Biletat zakonisht vihen në dispozicion të punonjësve të atij departamenti.
 - D. Një shishe uiski nga arkëtari i kompanisë.
10. Një Auditor i Brendshëm i Certifikuar (ABC) rezulton se ka kryer shkelje shumë të rëndë të Kodit të Etikës. Cila nga sa vijon përshkruan masën disiplinore më të mundshme që do të shqiptohet nga Organizata profesionale?
- Auditor i Brendshëm i Certifikuar (ABC) do të:
- A. Kërkohet të marrë deri në 40 orë trajnime të përshtatshme të edukimit të vazhdueshëm profesional.
 - B. Kërkohet të rimarrë provimin e ABC-së.
 - C. Humbas anëtarësimin e tij /saj në Organizatën profesionale.**
 - D. Gjobë që nuk kalon vlerën e 1,000€.
11. Cili nga veprimet e mëposhtme nga një auditor i brendshëm do të konsiderohej shkelje e Kodit të Etikës?
- A. Pjesëmarrja në një program edukues të ofruar nga një i audituar për të gjithë punonjësit.
 - B. Pranimi i biletave të linjës ajrore nga një i audituar.**
 - C. Shpalosjet, në një opinion auditimi, të të gjitha fakteve materiale të rëndësishme për fushën e auditimit.
 - D. Shitja e aksioneve të kompanisë përpara se të mësohet për një rënie të biznesit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

12. Nëpërmjet një auditimi të departamentit të arkëtimeve, shefi ekzekutiv i auditimit (CAE) u bë i vetëdijshëm për një anomali materiale të gjendjes së llogarive të arkëtueshme në fund të vitit. Auditori i jashtëm ka përfunduar auditimin pa zbuluar anomalitë. Çfarë duhet të bëjë shefi ekzekutiv i auditimit në këtë situatë?
- A. Informoni auditorin e jashtëm për anomali materiale.**
 - B. Raportoni anomalit materiale tek menaxhmenti kur auditori i jashtëm paraqet raportin e auditimit.
 - C. Largoni anomalit materiale nga raporti i auditimit të brendshëm pasi që auditori i jashtëm është përgjegjës për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare.
 - D. Kryen punë shtesë të auditimit në gjendjen e llogarive të arkëtueshme për të i dërguar punën auditorit të jashtëm.
13. Në një përmbledhje të shpenzimeve të udhëtimit, një Auditor i Brendshëm i Certifikuar (CIA) vuri në dyshim qëllimet biznesore të shpenzimeve të udhëtimit të rimbursuara të një Zyrtari. Zyrtari pretendoi se do të kompensonte shumat për të cilat u pyet nga auditorit duke mos kërkuar rimbursim për shpenzime të ligjshme në të ardhmen. Nëse zyrtari e përmbush premtimin, auditori i brendshëm:
- A. Mund të injorojë rimbursimet e bëra për shpenzimeve jo-biznesore.
 - B. Duhet të informojë organet tatimore në çdo rast.
 - C. Duhet të përfshijë të gjeturën në raportin e auditimit.**
 - D. Duhet të obligoj zyrtarin të kthejë çdo shpenzim të rimbursuar të marrë si pjesë e udhëtimit për qëllime jo-biznesore.
14. Një auditori të brendshëm të një kompani të madhe bankare rajonale iu kërkua të shërbente në bordin e drejtorëve të një banke lokale. Banka lokale konkurren në shumë tregje të njëjta si banka rajonale, por fokusohet më shumë në financimin e konsumatorëve individual sesa në financimin e bizneseve. Duke pranuar këtë pozicion, auditori:
- I. Shkel Kodin e Etikës të sepse shërbimi në bord mund të jetë në konflikt me interesat më të mira të punëdhënësit të auditorit.
 - II. Shkel Kodin e Etikës të sepse informacioni i marrë gjatë shërbimit në bordin e drejtorëve të bankës lokale mund të ndikojë në rekomandimet në lidhje me blerjet e mundshme.
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. I dhe II**
 - D. Asnjëra më sipër

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

15. Ditët e sotme Auditorët e brendshëm shpesh ndeshen me një gamë të gjerë dilemash të mundshme etike, jo të gjitha trajtohen në mënyrë eksplicite nga Kodi i Etikës. Nëse auditori ndeshet me një dilemë të tillë, auditori duhet gjithmonë:
- A. Të kërkoj këshilla nga një avokat i pavarur për të përcaktuar pasojat personale të veprimeve të mundshme.
 - B. Të marr parasysh të gjitha palët e prekura dhe pasojat e mundshme të veprimeve dhe të ndërmarr një veprim në përputhje me objektivat e auditimit të brendshëm dhe me parimet dhe rregullat e sjelljes të mishëruara në Kodin e Etikës.**
 - C. Të kërkoj këshilla nga komiteti i auditimit përpara se të vendos për një veprim.
 - D. Të veproj në përputhje me kodin e etikës të miratuar nga kompania edhe nëse një veprim i tillë nuk do të ishte në përputhje me Kodin e Etikës të Organizatës Profesionale.
16. Një auditor i brendshëm është caktuar për të audituar një filial të huaj. Auditori është i vetëdijshëm se klima sociale e vendit është e tillë që “pagesat lehtësuese” (ryshfetet) përdoren shpesh për të bërë gjërat të ndodhin dhe janë pjesë e pranuar e asaj shoqërie. Auditori ka përfunduar auditimin e një divizioni dhe ka gjetur mangësi të rëndësishme në lidhje me kontrollet kyçe. Menaxheri i divizionit i ofroj auditorit një “pagesë lehtësuese” të konsiderueshme për të hequr gjetjet e auditimit nga raporti i auditimit me një dispozitë që auditori mund të rishikojë divizionin brenda gjashtë muajve për të verifikuar nëse fushat problematike ishin adresuar siç duhet. Auditori duhet:
- A. Të mos pranoj pagesën pasi një pranim i tillë do të ishte në kundërshtim me Kodin e Etikës.**
 - B. Të mos pranoj pagesën, por të largoj gjetjet për sa kohë që ka një vizitë verifikimi në gjashtë muaj.
 - C. Të pranoj ofertën pasi është në përputhje me konceptet etike të vendit në të cilin divizioni po bën biznes.
 - D. Të pranoj pagesën sepse ajo ka efektin e të bërit të mirën e përgjithshme; auditori është më mirë, divizioni është më mirë dhe kompania është më mirë sepse ka një motivim të fortë për të korrigjuar mangësitë e gjetura nga auditori.
17. Auditorët e brendshëm ndonjëherë shprehin opinione në raportet e auditimit përveç deklarimit të fakteve. Kujdesi i duhur profesional kërkon që opinionet e auditorëve të jenë:
- A. Bazuar në evidenca të mjaftueshme faktike që garantojnë shprehjen e opinioneve.**
 - B. Bazuar në përvojë dhe të mos jenë të njëanshëm në asnjë mënyrë.
 - C. Shprehur vetëm kur kërkohet nga subjekti i audituar ose drejtuesi ekzekutiv.
 - D. Të kufizuar në efektivitetin e kontrolleve dhe përshtatshmërinë e trajtimeve kontabël.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

18. Në auditimin e departamentit të thesarit është caktuar një auditor i stafit për të dytin vit radhazi. Auditori konfirmoi letrat me vlerë të investimit të mbajtura nga një shtëpi brokerimi dhe kuptoi se disa letra me vlerë të mëdha ishin përdorur disa vite më parë në mënyrë të parregullt si kolateral për një kredi personale nga thesaristi aktual. Vitin e kaluar auditori i stafit kishte nënshkruar gabimisht hapat e auditimit që përfshinin konfirmimet dhe verifikimin e letrave me vlerë pa përfunduar të gjitha hapat. Menaxheri i auditimit gjithashtu nënshkroi gabimisht rishikimin vitin e kaluar. Kur u zbulua gabimi këtë vit, menaxheri i auditimit komentoi se "ishte një gabim, por kredia është shlyer dhe letrat me vlerë janë kthyer. Ne kemi korrigjuar dobësinë e kontrollit dhe jam pozitiv që nuk do të ndodhë më. Ndjekje e mëtutjeshme e kësaj çështje do të jetë turpëruese për të gjithë të përfshirët. Lëreni ashtu siç është."

Cila nga pohimet në vijim duhet të merret parasysh nga auditori i stafit kur vendos nëse do të raportojë situatën?

- A. Përdorimi jo i duhur i letrave me vlerë si kolateral.**
- B. Gabimi në nënshkrimin e punës që nuk u krye.
- C. Shlyerja e kredive dhe kthimi i letrave me vlerë.
- D. Korrigjimi i dobësisë së kontrollit.

19. Shefi ekzekutiv i auditimit (CAE) i një fabrikë prodhuese është në dijeni të mungesës së stoqeve material të shkaktuar nga mangësitë në kontrollin e brendshëm. Mungesa dhe shkaqet e lidhura me to janë të përmasave të mjaftueshme për të ndikuar në raportin e auditorit të jashtëm. Bazuar në Kodin e Etikës, identifikoni mënyrën më të përshtatshme të veprimit të shefit ekzekutiv të auditimit:

- A. Mos thuani asgjë; të ruhen nga ndërhyrja në pavarësinë e auditorëve të jashtëm.
- B. Diskutoni çështjen me menaxhmentin e fabrikës dhe ndërmerrni veprimet e duhura për të siguruar që auditorët e jashtëm të jenë të informuar.**
- C. Informoni auditorët e jashtëm për mundësinë e mungesës në stoqe, por lejojini ata të bëjnë një vlerësim të pavarur të shumës.
- D. Raportoni mungesat tek bordi i drejtorëve dhe lejojini ata t'ia raportojnë auditorit të jashtëm.

20. Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur dhe objektiv i ofrimit të sigurisë dhe i këshillave. Të gjitha opsionet e mëposhtme paraqesin qëllime për të cilat krijohet një departament i auditimit të brendshëm përveç njërit opsion:

- A. Për të shtuar vlerën e organizatës.
- B. Për të ndihmuar organizatën të përmbush objektivat.
- C. Për të përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.
- D. Për të mënjanuar nevojën për auditim të jashtëm të organizatës.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

21. Një sistem gjithëpërfshirës i kontrollit të menaxhmentit që merr në konsideratë si masat financiare ashtu edhe ato jo financiare në lidhje me faktorët kritik të suksesit të një kompanie quhet :

- A. Sistemi i vlerës së shtuar ekonomike
- B. Sistemi i vlerës së i shtuar të tregut
- C. Veprimtaria e bazuar mbi kosto
- D. Matrica e balancuar e vlerësimit**

22. Në një kompani të mesme ka ndodhur një mashtrim kur nëpunëses të kontabilitetit i' u delegua shumë përgjegjësi. Gjatë vitit, kompania ndërroi furnizimin e një shërbimi tek një furnitor i ri. Nënpunësja e kontabilitetit vazhdoi të paraqiste fatura mashtruese nga furnizuesi i vjetër. Për shkak se kontraktimi për shërbime dhe aprovimi i faturave të furnizimit i ishte deleguar nëpunëses, ishte e mundur që ajo të vazhdonte faturimet nga furnizuesi i vjetër dhe të depozitonte me postë çekun e mëvonshëm, për të cilin ajo ishte përgjegjëse, në një llogari të re që ajo hapi me emrin të furnizuesit të vjetër. Nënpunësja u konsiderua një punonjëse e shkëlqyeshëm dhe i' u dha përgjegjësia e shtuar për përgatitjen e buxheteve të departamentit. Kjo përgjegjësi e shtuar i lejoi asaj që në të vërtetë të buxhetoj për shumën e pagesave mashtruese.

Testet analitike mund të jenë të dobishme në zbulimin e mashtrimeve.

Cila nga procedurat e mëposhtme analitike ka të ngjarë të ketë sinjalizuar ekzistencën e mashtrimit?

- A. Shpenzimet aktuale të shërbimit dhe shpenzimet e periudhës paraardhëse**
- B. Buxheti në shpenzimet aktuale të shërbimit
- C. Prodhimi aktual me prodhimin e periudhës paraprake
- D. Kostoja e mallrave të shitura të kompanisë në krahasim me koston e mallrave të shitura të industrisë.

23. Përpilimi i raporteve të përjashtimeve është shembull i cilit kontroll nga sa vijon?

- A. Kontrollit zbulues
- B. Kontrollit parandalues
- C. Kontrollit korigjues**
- D. Kontrollit të direktivës

24. Funkzioni i auditimit të brendshëm të një organizate është pjesë integrale e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të organizatës. Parashikimet, buxhetet, dhe sistemet kompjuterike në kohë reale janë shembuj të:

- A. Kontrolleve reaguese (feed-back)
- B. Kontrolleve paraprake (feed-forward)**
- C. Planeve strategjike
- D. Politikave dhe procedurave

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

25. Menaxhmenti i një organizate jofitimprurëse ka monitoruar shpenzimet dhe është i shqetësuar sepse pagesat për disa furnitor duket se janë jashtëzakonisht të larta. Shumica e blerjeve bëhen përmes departamentit të blerjes, i cili është i organizuar rreth tre agjentëve, secili me zona të përcaktuara blerjeje. Agjentët e blerjes vendosin urdhëratë e blerjes dhe marrin kopje të raporteve të pranimi të mallrave për të siguruar që mallrat janë pranuar. Ata rishikojnë raportet e pranimi dhe i krahasojnë ato me urdhrat e blerjes përpara se t'i dërgojnë faturat në llogaritë e pagueshme me miratimin e tyre për pagesë. Të gjitha faturat e furnitorëve dërgohen drejtpërdrejt në llogaritë e pagueshme edhe pse marrja e raporteve të pranimi të mallrave së pari kalon përmes agjentëve të blerjes. Organizata ka një politikë për të kërkuar tri oferta për të gjitha blerjet që tejkalojnë shumën €10,000.

Cila nga deklaratat e mëposhtme në lidhje me përgjegjësinë e auditorit të brendshëm për zbulimin e mashtrimit në mjedisin e përshkruar në skenarin e mësipërm NUK është i saktë? Auditori duhet:

- A. Identifikoj dobësitë e kontrollit që mund të lejojnë të ndodhë mashtrimi.
- B. Vlerësoj treguesit e mashtrimit mjaftueshëm për të përcaktuar nëse duhet të zhvillohet një hetim mashtrimi.
- C. Kenë njohuri të mjaftueshme për të identifikuar saktë treguesit që mashtrimi mund të jetë kryer.
- D. Zbuloj mashtrimin nëse "treguesit e pranisë së mashtrimeve" janë të pranishëm në mjedis.**

26. Një auditor po heton punën e një divizioni me një rritje jashtëzakonisht të madhe të shitjeve, marzhit bruto dhe fitimit. Supozojmë se analiza tregon shitje jashtëzakonisht të larta dhe diferencë bruto gjatë muajve nëntor dhe dhjetor dhe auditori dëshiron të hetojë më tej.

Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte më efektive për të analizuar nëse shitjet mashtruese mund të jenë regjistruar?

- A. Merrni një mostër të dokumenteve të transportit dhe kërkon faturën e shitjeve të lidhura, duke u siguruar se të gjitha artikujt ishin faturuar siç duhet.
- B. Përdorni teknikat e analizës së regresionit për dhjetë muajt e parë për të vlerësuar shitjet dhe koston e mallrave të shitura për dy muajt e fundit.
- C. Konfirmoni llogaritë e arkëtueshme me klientë të mëdhenj.**
- D. Kryeni një rishikim analitik duke krahasuar shitjet dhe marzhin bruto me 10 muajt e kaluar dhe muajin e parë të vitit pasardhës.

27. Kontrollat e ashpra, të tilla si dokumentimi dhe testimi i aktiviteteve të kontrollit, duhet të vlerësohen në shtresën e dytë. Shtresa e dytë është në:

- A. Nivel organizativ
- B. Nivel procesi
- C. Niveli aktivitetit**
- D. Nivel departamenti

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

28. Menaxhmenti i një banke dyshon se një zyrtar i kredive kohëve të fundit krijonte kredi për kompani fiktive, duke arkëtuar shumat e kredive në llogarinë personale, dhe duke lënë kështu kreditë si të papaguara në kohë. Disa fakte përkatëse në lidhje me zyrtarin e kredisë përfshijnë:
- Një standard i lartë jetese, i shpjeguar si rezultat i investimeve të shëndosha dhe mos marrjes së pushimeve.
 - Një veturë e shtrenjtë personale e marrë përmes kontakteve të biznesit.
 - Faturat e benzinës dhe të riparimit të paraqitura për një makinë të caktuar të kompanisë që janë më të larta se mesatarja e kompanisë (regjistrat e kilometrazhit u dorëzuan në baza tremujore).
 - Potenco i se bezdiset me pyetjet e auditorëve.

Mashtrimi i mësipërm ka më pak gjasa të zbulohet nga:

- A. Analizat e numrit të kredive të bëra nga secili zyrtar kredie.
 - B. **Barazimi i kredive të papaguara me librin kryesor**
 - C. Auditimet e jashtme ose të brendshme të dosjeve të kredisë.
 - D. Analiza e vëllimit të përgjithshëm të kredive në shuma monetare nga zyrtari i kredisë.
29. Sipas raportit të COSO, sistemi i kontrollit të brendshëm të një entiteti është i përfshirë në të gjitha proceset themelore të mëposhtme të menaxhimit përveç:
- A. Planifikimit
 - B. Ekzekutimit
 - C. **Rrezikut**
 - D. Monitorimit
30. Një nëpunës i pagave me qasje të autorizuar në rrjetin lokal (LAN) ishte në gjendje të azhurnonte drejtpërdrejt skedarët e personelit të pavarur nga programet e aplikimit. Kontrolli më i mirë për të parandaluar një nëpunës të bëjë këtë do të ishte:
- A. Kufizoni qasjen në rrjetin lokal (LAN) me mjete të tilla si bllokimi automatik pas një periudhe të paracaktuar të mosveprimit të tastierës.
 - B. **Kufizoni qasjen dhe monitoroni instalimin e produkteve ose mjeteve softuerike që kanë aftësi të fuqishme azhurnimi.**
 - C. Përdorni sigurinë e fjalëkalimit për të vërtetuar përdoruesit ndërsa përpiqen të hyjnë në LAN.
 - D. Vendosni një politikë sigurie për departamentin që ndalon azhurnimin e drejtpërdrejtë të skedarëve të të dhënave.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

31. Sipas raportit të COSO, efektiviteti i një sistemi të kontrollit të brendshëm varet nga cila nga sa vijon?
- A. Gjendja e procesit**
 - B. Autorizimi i procesit
 - C. Miratimi i procesit
 - D. Përshkrimi i procesit
32. Auditorët e brendshëm duhet të ushtrojnë kujdes të duhur nëse duan të përmbushin përgjegjësitë e tyre për zbulimin e mashtrimit. Kështu, ekzistimi i kushteve të caktuara duhet të tërheq vëmendjen dhe të ngjallë skepticizëm profesional të auditorëve në lidhje me mashtrimet e mundshme. Cila nga sa vijon ka shumë të ngjarë të konsiderohet një tregues i mashtrimit të mundshëm?
- A. Një ekip i ri i menaxhmentit i krijuar si rezultat i zgjerimit në treg.
 - B. Ndryshimi i shpeshtë i drejtorëve financiarë.**
 - C. Zgjerim i shpejtë në tregjet e reja.
 - D. Një auditim i brendshëm i deklarimeve tatimore.
33. Po planifikohet një auditim i departamentit të kontrollit të cilësisë. Cila nga opsionet në vijim do të ishte më pak e mundshme të përdoret në përgatitjen e një pyetësori paraprake?
- A. Dosja e përhershme e auditimit.
 - B. Raporti paraprak i auditimit
 - C. Një analizë e dokumenteve të kontrollit të cilësisë.**
 - D. Struktura organizative e departamentit të kontrollit të cilësisë.
34. Drejtori ekzekutiv i një filiali ndërpreu kontratën një drejtori financiar dhe punësoi një zëvendësimit pa miratimin paraprak të korporatës. Drejtori financiar i ri dhe drejtori ekzekutiv manipuluan shitjet, rrjedhen e parave dhe statistikën e fitimeve përmes amortizimit të përshpejtuar dhe shitjes së pasurive kapitale për të marrë shpërblime më të mëdha të performancës për veten e tyre. Një qasje që mund të zbulojë këtë veprimtari mashtruese do të ishte:
- A. Të kërkohet intervista e daljes për të gjithë punonjësit që i' u është ndërprerë kontrata.
 - B. Analiza e kontrollit të përgjithshëm të menaxhmentit për ndarjen e detyrave.
 - C. Ndryshimet periodike të auditorëve të jashtëm.
 - D. Rishikim i rregullt analitik i ndarjeve operative.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Një listë e stoqeve që përbëhet nga afërsisht 2,050 artikuj të pa numëruar është rregulluar sipas kategorive, me 10 artikuj në secilën kategori. Brenda çdo kategorie, artikujt më të shtrenjtë (për njësi) renditen së pari. Një auditor dëshiron të përdorë një plan të mostrimit në interval për të zgjedhur një mostër përfaqësues prej të paktën 100 artikujsh nga kjo popullatë. Teknika më e mirë është të:
- A. Zgjidhni një numër të rastësishëm nga 1 në 20 si pikënisje dhe më pas zgjidhni çdo artikull të njëzetë, duke lëvizur nëpër të gjithë popullsinë.
 - B. Zgjidhni një numër të rastësishëm nga 1 në 15 si pikënisje dhe më pas zgjidhni çdo artikull të pesëmbëdhjetë derisa auditori të ketë 100 artikuj.
 - C. Zgjidhni shtatë shifra të rastësishme nga 1 në 135 si pika fillestare dhe më pas zgjidhni çdo artikull të 135-të, duke lëvizur në të gjithë popullsinë shtatë herë.**
 - D. Zgjidhni 50 artikujt më të mëdhenj (d.m.th., shtesat me shumat më të larta monetare); më pas, duke përjashtuar 50 artikujt më të shtrenjtë të përzgjedhur tashmë, zgjidhni një numër të rastësishëm nga 1 në 37 si pikënisje dhe zgjidhni çdo artikull të tridhjetë e shtatë, duke lëvizur nëpër të gjithë popullsinë.
36. Në një anketë rajonale të familjeve në zonat rurale për të marrë të dhëna për zakonet e shikimit të televizionit, fillimisht zgjidhet një mostër statistikore e zonave rurale. Brenda zonave të zgjedhura zgjidhen mostra statistikore të blloqeve të tëra dhe brenda blloqeve të përzgjedhura zgjidhen mostra të rastësishme të familjeve. Ky lloj i përzgjedhjes së mostrës mund të përshkruhet më së miri si:
- A. Mostrimi sipas veçorive
 - B. Mostër e rastësishme e shtresëzuar (e stratifikuar)
 - C. Mostra bashkësi.**
 - D. Ndryshore interval.
37. Ju duhet të kontrolloni afatet kohore të pagesës së faturave të blerjes bazuar në një mostër përfaqësuese të çeqeve të shkruara. Popullata e mostrës përbëhet nga gjithsej 967 çeqe me numër të njëpasnjëshëm që janë lëshuar për llogaritë e pagueshme. Metoda më e përshtatshme për nxjerrjen e një mostre të çeqeve është:
- A. Mostra bashkësi
 - B. Ndryshore interval
 - C. Mostra e thjeshtë e rastësishme.**
 - D. Mostër e rastësishme e shtresëzuar (e stratifikuar)
38. Një teknikë e mostrimit statistikor që do të zvogëloj madhësinë e mostrës sa herë që pritet një normë e ulët e mos - përputhshmërisë quhet:
- A. Mostrimi sipas veçorive.
 - B. Mostrimi i ndryshoreve
 - C. Mostër e rastësishme e shtresëzuar (e stratifikuar)
 - D. Plani i mostrimit ndal-dhe-shko**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

39. Për të llogaritur vlerën e 2,500 llogarive të arkëtueshme të papaguara, metoda më e mirë e mostrimit do të ishte:
- A. Mostrimi i ndryshoreve**
 - B. Plani i mostrimit ndal-dhe-shko.
 - C. Mostrimi në grup.
 - D. Mostrimi sipas veçorive
40. Një auditor dëshiron të përcaktojë shkallën në të cilën sistemi kompjuterik i burimeve njerëzore mund të përmbaj të dhëna të pavlefshme. Shembuj do të ishin një klasifikim i pavlefshëm i punës, mosha që tejkalon moshën e daljes në pension ose një klasifikim i pavlefshëm etnik. Qasja më e mirë për të përcaktuar shkallën e problemit të mundshëm do të ishte:
- A. Paraqisni të dhëna testimi për të testuar efektivitetin e kontrolleve të editimit të të dhënave mbi të dhënat e regjisturara.
 - B. Rishikoni dhe testoni kontrollet e aksesit për të siguruar që qasja është e kufizuar vetëm për individët e autorizuar.
 - C. Përdorni softuer të përgjithësuar të auditimit për të zhvilluar një raport të detajuar të të gjitha të dhënave jashtë parametrave të specifikuar.**
 - D. Përdorni softuer të përgjithshëm të auditimit për të zgjedhur një mostër punonjësish. Përdorni mostrën për të përcaktuar vlefshmërinë e të dhënave dhe projektioni rezultatin për popullatën në tërësi.
41. Një departament i auditimit të brendshëm zbatoi një strukturë testimi të integruar (ITF) për të testuar përpunimin e listës së pagave.
- Departamenti i auditimit identifikoi kontrollet kryesore dhe hapat e përpunimit të integruara në programin kompjuterik dhe zhvilloi të dhëna testimi bazuar në kontrollet kryesore dhe hapat e përpunimit me qëllim testimin e tyre. Departamenti dorëzoi transaksione testuese gjatë gjithë vitit. Duke supozuar se auditorët nuk gjetën ndonjë ndryshim në rezultatet e tyre të testit, auditorët mund të konkludojnë se:
- A. Sistemi po regjistron siç duhet orët e punës nga punonjësit gjatë vitit dhe orët janë dorëzuar siç duhet në listën e pagave dhe janë përpunuar në mënyrë korrekte.
 - B. Të gjithë punonjësit janë paguar saktë gjatë vitit dhe paga e tyre është llogaritur saktë.
 - C. Aplikacioni kompjuterik dhe procedurat e tij të kontrollit po përpunonin në mënyrë korrekte transaksionet e listës së pagave gjatë vitit të kaluar.**
 - D. Të gjitha të mësipërmet.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

42. Më poshtë janë renditur katër shembuj të llojeve të zakonshme të evidencës së auditimit.

- I. Bisedimi me menaxhmentit
- II. Vëzhgimi i procedurave të të audituarit
- III. Ekzaminim fizik
- IV. Dokumentacioni i përgatitur nga jashtë

Cila nga opsionet e mëposhtme përfaqëson rendin e përgjithshëm të evidencave besueshme, nga më besueshmet tek evidencat më pak të besueshme, për llojet e evidencave të listuara më sipër?

- A. III, IV, II, I.**
- B. IV, I, II, III.
- C. II, IV, I, III.
- D. IV, III, I, II.

43. Auditori i brendshëm i një kompanie me interes publik ka në dispozicion informacionin e mëposhtëm për të shkruar një memorandum mbi ecurinë e zhvillimit të softuerit të ri të auditimit për llogaritë e arkëtueshme:

Programuesit që do të fillonin përgatitjen e softuerit të mostrimit javën e kaluar nuk do të mund të fillojnë punën deri në javën e ardhshme. Programuesit duan të shpenzojnë €5,000 për një paketë softuerike të disponueshme në treg. €5,000 për paketën softuerike nuk janë në buxhet. Duke përdorur softuerin, programuesit presin të përfundojnë punën e tyre sipas planit. Kostot e programimit do të reduktohen me €12,500 nëse programuesit mund të përdorin softuerin e blerë. Softueri të mostrimit pritet të përfundojë një javë më herët. Projekti i përgjithshëm pritet të përfundojë në kohë. Përveç paketës softuerike dhe kostove të programimit, projekti është me buxhet.

Mesazhi më i rëndësishëm që auditori duhet t'i përcjellë menaxhmentit të lartë është:

- A. Zhvillimi i softuerit të ri të auditimit është prapa afatit.
- B. Programuesit duan të blejnë softuer të ri që kushton €5,000.
- C. Projekti pritet të përfundojë në kohë dhe brenda buxhetit.**
- D. Softueri i mostrimit do të përfundojë një javë më herët.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

44. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të siguronte evidencën më pak të besueshme që kompania kishte përfshirë të gjithë borxhin e saj të papaguar në një raportim të fundit që u bë publik?
- A. Dërgoni konfirmime bankare për të gjitha bankat që kanë bërë biznes me kompaninë, duke kërkuar informacion për borxhet e papaguara.
 - B. Përgatitni një plan të borxheve të papaguara duke përdorur listën e detyrimeve të pagueshme të përgatitur nga kompania dhe gjurmoni ato në librin kryesor dhe shënimet shpjeguese (shpalosjet).**
 - C. Krahasoni shënimet shpjeguese (shpalosjet) në raportin e auditimit të vitit të kaluar të publikuar me shënimet shpjeguese të këtij viti dhe rakordoni dallimet.
 - D. Testet analitike të shpenzimeve të interesit ndaj borxhit
45. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit ofron dëshminë më të mirë në lidhje me mbledhjen e llogarive të arkëtueshme?
- A. Konfirmimi i gjendjeve të arkëtueshme me debitorët.
 - B. Ekzaminimi i shënimeve për nënshkrimet e duhura të debitorëve.
 - C. Barazimi i detajeve të arkëtimit të parave dhe provizionit për shuma të pa-arkëtueshme me librin kryesor.
 - D. Ekzaminimi i regjistrave të arkëtimit të parave të gatshme për të përcaktuar shpejtësinë e pagesave.**
46. Dy deklaratat e mëposhtme janë rezultat i një auditimi të kontrolleve të parasë së gatshme të një organizate. Në mënyrë të veçantë, deklaratat ishin pjesë e evidencave të mbledhura për të përmbushur objektivin e auditimit për "përcaktimin nëse të gjitha arkëtimet e parave të gatshme depozitohen të paprekura çdo ditë".
- Gjatë një interviste, i kontrolluari e siguroi një auditor të brendshëm se të gjitha pranimet e parave të gatshme depozitohen sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Një krahasim i një mostre të listave të arkëtimit të parave të gatshme me totalin e regjistrimeve ditore të arkëtimit dhe shumave ditore të depozituara në banka zbuloi se (1) secila listë e arkëtimit të parave të gatshme ishte e barabartë me shumën e hyrjes në ditar të parave, por jo me shumën ditore të depozitave bankare dhe (2) çdo listë e arkëtimit të parave të gatshme është e barabartë me totalin e depozitave bankare në terma afatgjatë.
- Si dëshmi për të mbështetur një konstatim se "Depozitat në para nuk depozitohen të paprekura çdo ditë", Deklarata 2 është:
- A. E mjaftueshme, por jo kompetente apo relevante.
 - B. E mjaftueshme, kompetente dhe relevante.**
 - C. E pa mjaftueshme, kompetente ose relevante.
 - D. Relevant por jo e mjaftueshëm apo kompetent.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

47. Një auditor po kryen një rishikim analitik të operacioneve të divizionit dhe vë në dukje sa vijon:

- Raporti (koeficienti) aktual po rritet.
- Koeficienti i shpejtë po zvogëlohet.
- Numri i ditëve të shitjeve të inventarit po rritet.
- Shitjet janë konstante.
- Detyrimet afatshkurta janë konstante.

Nga kjo, auditori mund të konkludojë se:

- I. Kompania ka prodhuar më pak produkte këtë vit se vitin e kaluar.
- II. Paratë e gatshme ose llogaritë e arkëtueshme janë ulur.
- III. Marzha bruto është ulur.

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II**
- C. I dhe II
- D. II dhe III

48. Cili nga opsionet në vijim është burimi më i mirë për t' u përdorur nga një ekip auditimi për të identifikuar rreziqet e zakonshme me të cilat përballet një kompani?

- A. Listat e kontrollit ose listat rikujtuese.
- B. Grafikët e rrjedhës.
- C. Pyetësorë.
- D. Hulumtimet e publikuara në revista profesionale dhe tekste shkollore.**

49. Për të testuar nëse debitimet ndaj llogarive të arkëtueshme përfaqësojnë transaksione që kanë ndodhur, auditori duhet të gjurmojë regjistrimet nga:

- A. Libri i shitjeve në librin e llogarive të arkëtueshme.
- B. Libri i llogarive të arkëtueshme në ditarin e arkëttimeve të parave të gatshme.
- C. Libri i llogarive të arkëtueshme në librin e shitjeve.**
- D. Dokumentacioni i arkëttimeve të parave të gatshme në librin e llogarive të arkëtueshme.

50. Çfarë lloj evidencash paraqesin fotografitë?

- A. Evidenca rrethimore.
- B. Evidenca të drejtpërdrejtë.
- C. Evidenca vërtetuese.
- D. Evidenca thashetheme.**